Ndër kushtet që më së shumti meritojnë t'i përmbushni janë ato përmes të cilave ju lejohet afrimi me gratë tuaja

Ukbe ibën Amiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Ndër kushtet që më së shumti meritojnë t'i përmbushni janë ato përmes të cilave ju lejohet afrimi me gratë tuaja."

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se kushtet më të rëndësishme që meritojnë të përmbushen janë ato përmes të cilave lejohet të kënaqurit me gruan dhe këto janë kushtet e lejuara që i kërkon gruaja në kontratën e martesës.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/6021